



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

6061
17.11.11

V E N D I M

Nr. 781 , datë 10.11.2011

P Ë R

LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE
PRIVATE "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Licencimin e shkollës së lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", Tiranë, në emër të shoqërisë "T.A.L.M.-Albania", sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Shkolla e Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", Tiranë, të organizohet në dy fakultete:
 - a) Fakulteti i Ekonomisë, që ofron programet e studimit të ciklit të parë në:
 - i. Administrim biznesi;
 - ii. Administrim biznesi dhe Teknologji informacioni.
 - b) Fakulteti i Inxhinierisë, që do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:
 - i. Inxhinieri softuerike;
 - ii. Inxhinieri industriale.



3. Shkolla e lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", Tiranë, të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tre) vite akademike dhe me realizimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë "Bachelor" në:

- a) Administrim biznesi;
- b) Administrim biznesi dhe Teknologji informacioni;
- c) Inxhinieri softuerike;
- ç) Inxhinieri industriale.

4. Shkolla e lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.


7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI


SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAFAJ




NR.PROT.3345
DATË 16.11.2011

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA

Sekretari i Përgjithshëm

